

INTERVISTË ME EMIN BIKLIQIN

Janjevë | Data: 1 korrik, 2019

Kohëzgjatja: 96 minuta

Të pranishëm:

1. Emin Bikliqi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Emin Bikliqi: Fëmijëria në atë kohë, si t'gjitha trevat tona... nuk ka qenë e lehtë, domethanë kushtet socio-ekonomike kanë qenë në nivel jo të lakmushëm. Mirëpo, Janjeva sado kudo ka qenë në ambient i kryqëzimeve të dy-tri civilizimeve, bizantine, romake dhe orientale. Edhe unë jam rritur dhe zhvilluar në vitet e para të fëmijërisë në ato rrethana të Janjevës.

Mirëpo Janjeva është dalluar pak a shumë në pikëpamje të zhvillimit social edhe ekonomik në krahasim me vendet tjera. Për arsye se ne kemi jetuar me kroatët. E kroatët kanë pasur në civilizim ma të avancuar. Për shkak se ata kanë qenë në lidhje të përhershme me Kroacinë, me Zagrebin, me Dubrovnikun.

Ju keni marrë vesh me siguri prej të tjerëve se kroatët e Janjevës e kanë prejardhjen prej Dubrovnikut. Në shekullin e XII-të kanë ardhë në Janjevë, domethanë në kohën e Nemanjiçëve. Ata i kanë sjellë kta si tregtarë dhe si zejtarë. Prandaj, ne kemi nda fatin e tyre që disa vlera edhe materiale edhe shpirtërore t'i marrim prej tyre.

Mu m'kujtohet në fëmijëri e mirë e në bashkëjetese. Na fqinjë i kemi pasur kroatë edhe ata fëmi kanë qenë si... fqinjë të mirë me ne. Ne kemi kaluar shumë bukur, si me kroatë, si me shqiptarë, si me turqi. Po edhe romë kemi pasur dhe ka ende në Janjevë edhe romë. Kështu që, vërtetë ka qenë në bashkëjetesë, që thonë në shembull qysh duhet të jetohet e të punohet.

Anita Susuri: Në cilën pjesë të Janjevës ju keni jetu si fëmi?

Emin Bikliqi: Në cilën pjesë?

Anita Susuri: Po.

Emin Bikliqi: Une jam i lindur në një shtëpi, të them, jo afër çarshijes. Ne i kemi pasur shtëpitë afër çarshisë, afër xhamisë. Ndoshta iu kanë tregu edhe tjetër. Domethanë na jemi autokton aty, gati 600 vjet. Ndoshta këtë pjesë e keni absorbu, tash s'e di sa iu kujtohet, prej nga janjevasit? Prej nga familja ime, për shembull Bikliqi? A keni kuptu këtë prej tjerëve?

Anita Susuri: Me mustaqe diçka?

Emin Bikliqi: Po, po.

Anita Susuri: Po na tregoni edhe ju pak ma shumë.

Emin Bikliqi: Bon edhe ma vonë, bon edhe tani të ju tregoj. Kto ju i qitni në letër apo?

Anita Susuri: Janë të gjitha të regjistrueme edhe domethanë...

Emin Bikliqi: Ju besoj ju kanë tregu edhe ata kusheritë e mi, apo prej nga e kemi prejardhjen. Sipas gojëdhanës prej vitit 1453, domethanë kur kanë ardhë ushtria otomane edhe t'parët tanë kanë ardhë, dhe sipas gojëdhanës ata paskan ardhë prej Kaukazit. Shkurt ose ma qartë prej Gjeorgjisë së sotme, ni vend afër Tibilisit, Akaska i thonë turqisht, në gjuhën gjorgjiane Akalistiki i thonë atij vendi. Mu m'ka interesu pak a shumë, s'kom marr shumë shënime po në internet çka kam gjetur diçka. Domethanë prejardhja jonë osht' nga ai vend.

Anita Susuri: Vetëm familja juj apo...

Emin Bikliqi: Jo, Bikliqët.

Anita Susuri: Apo komuniteti turk?

Emin Bikliqi: Po, komuniteti turk. Disa thonë që kanë ardhë prej Sirie në atë kohë me ushtrinë otomane, e për tontë thonë se kanë ardhë prej Kaukazit të vogël. Edhe tash është ndoshta interesant të ju spjegoj nëse nuk e keni kuptuar nga të tjerët, e çka na tash? Deri vonë ni numër i familjeve Bikliqëve nuk kanë ditur shqip. Vonë... po mendoj para 50-60 vjetëve, 70 vjetëve nuk kanë ditur shqip, domethanë kanë folur turqisht. Ni pjesë ka folur shqip. Unë në familjen time kam folur shqip. Nana ma shqiptare, baba turk edhe ne në familje kemi folur gjuhën shqipe. Unë i kom shtatë motra dhe të gjitha e kanë folur vetëm shqipen në familje edhe tash shtrohet pytja, çka jemi na tash?

Kemi ardhë, jetojmë ktu afër 600 vjet... tash në pikëpamje sociologjike nëse bohet analiza e kësaj çashtje, çka qenia jonë? Knej turqi që kanë folë turqisht e atë e ktë, e tjera... Mirëpo në rrethanat e ambientit kosovar, në rrethanat e Janjevës konkretisht nuk kam pasur shumë kontakte me të tjerët, turqit e Janjevës, domethanë me Prizren, me Vushtrri e me Mitrovicë ku kanë... ose Gjilan ku kanë jetu turqit edhe martesat i kanë bo kryesisht me shqiptare. Edhe Janjevën e ka konsideru rrethina si qytet, ka qenë me kushte ma të mira në krahasim me vendet e tjera.

Edhe tash, në fund çka? Ndoshta iu kanë shpjegu ndryshimet. Ne kemi pasë Biekli deri në Luftërat Ballkanike mbiemrin. Biekli do të thotë musteçok. Pas Luftërave Ballkanike ia kanë shtu edhe shtësen "q", serbosllavët a qysh i themi. Edhe ni kohë e kemi pasë mbiemrin Bikliq. Sot e kësaj dite disa e kanë edhe Bikliq mbiemrin. Ka familje plot që janë në Turqi, atyne ua kanë ndrru mbiemrin e dini këtë

praktikë. Mirëpo ni familje e jonë ka qenë me kushte ma të mira financiare, kur kanë shku në kufi iu kanë dhanë para në kufi edhe kanë thanë, “A bon t’mos ma ndrroni mbiemrin? Ma leni Bikliq”.

Edhe ata sot e kësaj dite jetojnë në Stamboll me mbiemrin Bikliq, që osht’ rast i rallë mos me ua ndrrue shqiptarëve mbiemrin në Turqi. Do të thotë, ka Bikliq në Turqi, në disa vende, në disa qendra, mandej ka në Europë që kanë shkue mas viteve të ‘70-ta për punësim e tjera e tjera. Edhe tash shtrohet pytja e çka na? Unë e kam krye tetë vjeçaren në Janjevë, katër klasët e para në gjuhën shqipe. Ka pasë mësus te paralelja në gjuhën shqipe, në gjuhën turke nuk ka pasur.

Pastaj, pas klasës t’katërt nuk ka pasë paralele në gjuhën shqipe për klastë e pesta deri në të tetën, domethanë për pjesën e dytë të tetë vjeçarës. Edhe ne bashkë me Skenderin, që ishit në zyrën e tij edhe disa të tjerë kusheri edhe vendas e këta ose të rrethinës jemi regjistru në paralelen kroate. Ne s’kem pasë mundësi të udhëtojmë në atë kohë, s’ka pasë autobusa me shku ku na u ka dashtë në Prishtinë apo nuk e di... ndoshta në Gadime, po Gadimja larg... edhe që ka pasë naj tetë vjeçare kështu të plotë në gjuhën shqipe. Edhe ne katër klastë e larta të tetë vjeçarës i kemi kry në gjuhën kroate ose serbo-kroate i kemi thanë.

Anita Susuri: Në cilin objekt në Janjevë i keni përfundu?

Emin Bikliqi: Katër klastë e para... ndoshta keni qenë në Kishën e Janjevës, osht’ ni objekt, Shoqata e Rinijes që osht’?

Anita Susuri: Po.

Emin Bikliqi: Aty katër vjet, ka qenë ajo e kishës po pas Luftës të Dytë Botnore pushteti ua ka marrë objektin edhe na aty i kemi kry katër klasë.

Anita Susuri: A ka pasë emën ajo? A ka qenë si shkollë apo veç...

Emin Bikliqi: “Vladimir Nazor”.

Anita Susuri: Ajo ka qenë fillimisht “Vladimir Nazor”.

Emin Bikliqi: Po, po. Fillimisht “Vladimir Nazor” ka qenë. Domethanë, klasën e pestë ne e kemi vazhdu në objektin, tash të vjetër s’di a ju kujtohet?

Anita Susuri: Po, po.

Emin Bikliqi: Ajo shkollë tash nuk është funksionale se osht’ shkatërru, osht’ ndërto objekti i ri. Në atë objektin e vjetër, aty i kemi kry katër klastë e tetë vjeçares. Domethanë, unë tetë vjeçaren e kam kry edhe, tash i bjen të lavdohem, kam qenë kryetar i rinisë në atë kohë. Shqiptar, ashtu unë jam llogaritur shqiptar, ju spjegoj pse masanej edhe pse sot e ndjej vetën. Edhe kom qenë nxanës i shkëlqyshëm. Më merrshin arsimtartë më çojshin në paralele tjera për gjuhën kroate.

Unë e mësova edhe gjuhën kroate, por e kam ditur gjuhën kroate, për gramatikë qysh duhet të flasim nxansat ose n'pytjet për gramatikë. Ata nuk ishin të interesuar kroatët për shkollim. E kështu, pak si lavdë po i bjen nuk është në rregull kështu po (qeshë). Edhe pastaj jam regjistruar në Shkollën Normale të Prishtinës në vitin...

Anita Susuri: Para se të vazhdojmë me Prishtinën...

Emin Bikliqi: Ende Janjevë a?

Anita Sususi: Dashta me u kthy edhe pak në Janjevë. A mundeni me na spjegu...

Emin Bikliqi: Jo tash po iu spjegoj këtë. M'falni. Ta kryj edhe këtë, të iu spjegoj edhe këtë. Çka qenia ime? Çka qenia jonë? Edhe unë mbiemrin e kom Bikliqi, domethanë me "i". Por kjo osht' periudha kur kom ardhë në Prishtinë, jam vetëdijësu për disa çështje edhe kam bo kërkesë në ofiçarinë e Janjevës, ka qenë viti i dytë a i tretë i Normales, të mos më mbetet mbiemri Bikliq, por Bikliqi. Kam bo me shkrim kërkesën edhe jam i pari që ia kemi shtu edhe këtë prapashtesë me "i" edhe pastaj kanë fillu edhe disa tjerë. Edhe i bjen që unë jom i pari gati aty që kam regjistru shkollën e mesme, kam vazhdu e tjera e tjera.

Edhe tash prapë të kthehem në Janjevë. Në Janjevë, çfarë përshtypje kam unë për shembull? Ose para asaj, shkojmë deri n'fund me qenien kombëtare, do të thotë prejardhja të gjitha këto, rrethanat, raportet, marrëdhانيت. Edhe na, na kemi krijuë... tash janjevasit, Bikliqtë kryesisht, jo të gjithë, a osht' qashtu? Ne kemi kriju qenien shoqërore shqiptare. Nana shqiptare, shkollimi në gjuhën shqipe, martesat, jo vetëm e imja po edhe tjerat edhe ndikimet tjera... domethanë, me shtyp, e me literaturë e me t'gjitha ne e kemi qenien, prejardhjen... iu tregova çfare. Mirëpo, sot e kemi qenien tonë shqiptare edhe veten e ndijmë shqiptarë.

Tash po kthehem prapë në Janjevë, çfarë përshtypje kam? Për shembull, prej fqinjëve t'mi kroat që kemi pasur? M'dukët është element i randësishëm. M'kujtohet në atë kohë ka ndodhë, për shembull, me të ardhë mysafir edhe mos t'kemi kafe ose sheqer, në atë kohë kështu ka qenë pas viteve të '50-ta. Edhe nana m'thonte, "Shko te Marta..." Marta ni fqinje kroate, edhe thonte, "pak sheqer ose kafe". Edhe ka qenë ajo shumë indikative edhe që e kom mbajtë në mend, m'ka lanë mbresë. Nëse nuk e ka pasur për shembull, me ta dhanë ni filxhan sheqer ose kafe ose nji mjet për punë, ni tërfurk ose diçka, ka thanë, "Prit pak". Ka shku te fqinji tjetër kroat ta ka siguru edhe ta ka sjellë. Me fjalë të tjera, nuk të kanë kthy pa të shërby. Ajo është vlerë njerëzore, universale, a osht' qashtu? Osht' kulturë, osht' civilizim.

Ajo që m'ka mbetë. Edhe unë gjithherë e potencoj ose e kam potencuar këtu në Prishtinë kur kam ardhur. Mandej, tjetër çka është ajo mbresa që m'ka mbetë prej Janjevës? Për festat e Bajramit, për Shën Gjergj, ndoshta ju kanë tregu ata? Ka qenë shumë interesant se ne i kemi pasë disa mjete. Kemi pasë tarabukë, kemi pasë def edhe kitarë. Une në atë kohë, para Luftës të Dytë Botnore e kom pasë

mixhën në Gjermani. Ai na ka sjellë gramofon në atë kohë, në atë kohë. Ai atje ka punu, na ka sjellë edhe mjete tjera nga Gjermania që për të tjerët... s'kanë ditë çka osht' ajo.

Edhe ku e pata fjalën për festë të Bajramit, për Shën Gjergj ose festë kështu, ata që ishin ma të vjetër se na dilnin rrugës, na si fëmi shkojshim mbrapa tyne edhe këndonin nëpër rrugët e Janjevës. Ju i keni pa qysh janë të stilit të Dubrovnikut, rrugët e ngushta. Ju s'keni qenë ndoshta?

Anita Susuri: Po, po, kemi qenë.

Emin Bikliqi: E pasni qenë. Me kalldërm, tash i kanë shtru me kubza e tjera, por ka qenë me kalldërm. Edhe rrugëve duke kënduar kangë turke edhe shqipe. Ajo ka qenë diçka mbresëlanëse. Pastaj për Shën Gjergj, për shembull nanat na thonin duhet të zgjoheni herët, të mledhim lule, të pastrohemi me atë ujë e tjera e tjera. Edhe bënim hululaja. Drunjë keni pa atje, dardha, pemë, arra të mëdha. Edhe dy-tri ditë zgjaste manifestimi i Shën Gjergjit, ditës së Shën Gjergjit. Mirëpo atë bukurinë e Shën Gjergjit edhe ma shumë e zmadhonin romët. Ata e konsideronin si festë kombëtare të tyne. Edhe ata me tupan e me surla, me mjetet e tyre muzikore e bojshin edhe ma të bukur atë ambient.

Tjetër çka osht' e randësishme t'them për Janjevën që e mbaj në mend edhe e përmendi edhe në Prishtinë, kur kam ardhë edhe gjithkund kur kom pasë kontakt me njerëzit. Ka qenë rregull, sidomos t'flas drejtë te kroatët, ata e kanë pasë obligim të premtëve në mbramje secili para derës t'vet me marr me pastrue kalldërmën edhe mos me lanë kun... për bërlllog mos t'flasim, por as pluhur as kurgjo. Me marrë me ujë edhe t'shtuneve rrugët e... ato rrugicat e Janjevës kanë qenë të pastra. Ajo që e mbaj në mend. Me fjalë të tjera, ajo osht' ni vlerë materiale, osht' kulturë, a osht' qashtu?

Besarta Breznica: E pse ka ndodhë bash t'premtëve?

Emin Bikliqi: Po t'premtën për t'shtunën se t'shtunën edhe t'dillën... t'shtunën ata punonin, mirëpo të dieleve nuk punojnë kroatët, katolik. Edhe ata, nëse ke shku diçka me të kry ndonjë punë kanë thanë, "M'fal une e kom ditë pushimi, e kom festë". Ata e konsiderojnë festë. Edhe i kom pytë sikur ju që po m'pytni, "Pse të premtën?" Se prifti të shtunën del rrugëve të Janjevës në kohën e caktuar edhe shëtitë. Edhe kur kalon prifti, kur ka kaluar në të vërtetë prifti... tash nuk e di. Kur ka kaluar prifti, kroatët kanë dalë të gjithë para derës me përshëndet.

Anita Susuri: Ndoshta edhe që ka qenë pazar ditë e premtë? A ka edhe ajo lidhje?

Emin Bikliqi: Jo, lidhje ajo... t'premtëve ndoshta e kanë përly ma tepër (qeshë), njerëzit që kanë ardhë nga rrethina. Po ma tepër ka qenë ai aspekti tjetër, që për vikend duhet t'jenë rrugët e pastra. Edhe ni moment ka qenë i randësishëm, unë i kam pytë shoktë e mi, "Pse?" Në atë kohë, edhe ma vonë kam biseduar me shokë kroat. Ata ma shumë kanë pri mandej na edhe tu i pa ata edhe na jemi mundu diçka t'bojmë. Edhe ata m'kanë thanë, "Të shtunave..." kisha osht' shumë e organizume, ka qenë edhe ka mbetë. Në atë kohë, para 40-50 vjetëve, e ku ta di ajo ka qenë shumë e organizume.

Ndoshta keni marrë vesh aty. Kori i Janjevës dikund në vitin '70 e sa, s'e di sakt, e ka nrxanë venin e parë në Jugosllavi si kor dhe kisha e ka pasë profesorin e Edukatës Muzikore në Kosovë nuk ka pasë të diplomuar. Ato momente që i thashë për janjevasit, për një ngritje kulturore, civilizuese e tjera. Ata kanë pri. Jo vetëm ndaj neve aty po edhe ndaj... për Kosovën kanë qenë shembull e sot ka mbetë Janjeva në fund t'pusit.

Edhe i kam pytur, "Pse?" Ju që po m'pytni, "Pse t'premten?" Se prifti të shtunave del rrugëve të Janjevës, n'kohën e caktuar edhe shëtitë. Edhe kur kalon prifti, kur ka kalu në të vërtetë, tash nuk e di. Kur ka kalu prifti, kroatët kanë dalë t'gjithë para derës me përshëndetë. E na, kënd e përshëndetim ashtu? (Qeshë) Ajo ka qenë traditë edhe kulturë edhe kjo sigurisht ka ndiku që të pastrohen rrugët. Domethanë, ka qenë ni lidhje aty, ka qenë ni obligim, ni përgjegjësi e tjera. Po ajo është mbjellë mandej si vlerë. Si vlerë edukative, kulturore, higjienike. Domethanë, në atë kohë, para 60 vjet e ma shumë osht' praktiku. Atë që e mbaj në mend, sigurisht edhe ma herët por unë po flas për periudhën që unë e mbaj në mend.

Anita Susuri: E si kanë qenë të premtet, ato ditët e pazarit?

Emin Bikliqi: Pazari ka qenë mrekulli.

Anita Susuri: Çfarë atmosfere ka pasë?

Emin Bikliqi: Shumë atmosferë e mirë, përplot ato rrugë... pazari është mbajtë afër Çarshisë, tash p'e dini Skenderi ku e ka zyrën, po ka qenë ni hapsinë pak ma e madhe përplot. Edhe këta kroatët sidomos, se na jo, kanë pasë para se kanë qenë tregtarë ata kanë shku nëpër gjithë Jugosllavinë. Edhe janë marrë me manufakturë, secila shtëpi ka qenë fabrikë e vogël. Në atë kohë kur s'ka pasë lugë ose na kem përdorë në Kosovë lugë të drurit ata kanë prodhu lugë të aluminit, edhe pjata të ndryshme të aluminit edhe mjete të ndryshme.

Masandej kanë fillu me pllataka, ndoshta iu kujtohet. Domethanë, janjevasit janë t'partë ata që... e masnej është hapë tregu që i Kinës e tjera ajo është tjetër çashje, tjetër periudhë ajo periudhë e re e tjera e tjera. Edhe kjo osht' ajo, ajo pjesa domethanë interesante e tregut. Çka kanë pru, për shembull, rrethina edhe shqiptarë edhe serbët... fshatrat përreth janë edhe shqiptarë edhe serbë, i keni kuptu e dini cilat janë e tjera. Ata kanë sjellë aty prodhime e veta vezë, pula, viça, ku ta di e tjera. Prodhime të ndryshme edhe të gjitha janë shitë.

Edhe diçka osht' interesant që unë e kam përmend çdo here, që m'ka lanë mbresë, nëse dikush e ka humbur, që ka ardhë, kuletën me para edhe nëse e ka gjetë kroati e ka marrë e ka çu në kishë. Edhe njerezit janë drejtu në kishë edhe prifti i ka thanë, "Çfarë duket kuleta?" Ia ka përshkru. Ka thanë, "Qe kuleta me pare me krejt". Ose e ka humbur sopatën, në atë kohë sopata ka qenë mjet i vlefshëm ose diçka tjetër... e ka harru atë strajcën me diçka edhe nëse e ka gjetë kroati... unë s'po flas tash për këtë pjesën tjetër, nëse e ka gjetë kroati ka shku e ka dërgue në kishë edhe në kishë e kanë gjetë.

Edhe tjetër, çka m'la mbresë në fëmijërinë time, maskenballi që janë organizu, dikund në shkurt organizohen. A ju kanë tregu për këtë?

Anita Susuri: Jo.

Emin Bikliqi: O maskenballi osht' vlerë kulturore, osht' civilizim. Merreni me mend para 60 vjeteve, në televizion ndoshta i keni pa, në Dalmaci qysh organizojnë me stilin e pranverës me mimozat kur fillojnë, karnevalet që i bojnë. Në Janjevë janë ba domethanë në kohën e fëminisë time. Edhe ka qenë ni problem... unë kam qenë për shembull në klasën parë, të dytë edhe shkonim deri te kisha, aty ku e kemi pasë objektin e shkollës. Edhe për karnevale ata mashkullit visheshin si femra, femrat si mashkuj. Mandej mashkujt me lëkura i kthejshin mrapsht, me sene të shkyera, me pangla që i themi në gjuhën popullore edhe qitshin brina të viçave, të bujve që i kanë pre me qenë sa ma trishtus. Edhe na frikoheshim edhe i thojsha babës, "Bab, çomë te shkolla se s'guxoj". Në atë kohë ka pasë qeze i thonë, ni mjet transporti me dy rrotë me kali. Edhe ata me qeze eneshin, këndonin, me tërfurka kështu si shtriga, si... për neve, sot frikohemi me i pa lemo në atë kohë si fëmijë, dhe ajo ka qenë mbresëlënëse.

Edhe kta une ia tregojsha shokve këtu, ata vetëm më shikonin kështu gojëhapur. Ata nuk dinin se përvoja të tjera... Ndoshta në Prizren ka mujtë me ndodhë, nuk e di për Prizren, unë po flas për Janjevë. Edhe ka qenë si film në atë kohë, kur iu tregojsha në Normale. Edhe diçka tjetër që është e rëndësishme...

Anita Susuri: A janë organizu kto në kishë e pastaj kanë vazhdu në qytet?

Emin Bikliqi: Po kisha ka qenë iniciatore me siguri, kisha...

Anita Susuri: A po shtëpia e kulturës?

Emin Bikliqi: Ja, ja kisha besoj. Me iniciativë ka qenë ndoshta edhe shtëpia e kulturës po nuk e di. Në atë kohë unë besoj që kisha ka qenë ai promotori për shumë çka. Ama kisha i ka organizu, i ka orientu e tjera e tjera. Ndoshta edhe shtëpia e kulturës unë nuk e di në atë kohë qysh ka qenë. Mirëpo edhe diçka tjetër, edhe ni vlerë civilizuese interesante... krejt po i lidhi me Prishtinën kur kam ardhë në Prishtinë edhe iu spjegojsha shokëve t'mi që vishin nga pjesë të ndryshme të Kosovës për Normale. Kanë qenë serenatat, në atë kohë.

Edhe unë kam qenë paralel, iu tregova në gjuhën kroate, paralelet e larta 13 vjeçar, 14, 15 njeri e ndjen vetën pak jo me u dashuru, jo me pa ndonjë vajzë. Ka pasë vajza të bukura, ato kanë qenë ma të veshura se vajzat e tjera shqiptare e turke për arsye se i kanë pasë kushtet. Tash krejt po lidhet me kushte. Kanë qenë me fustana të bukur që i kanë sjellë prej Zagrebit e ku ta di unë, ajo ka qenë si film. E normal unë shoqe të klasës kom pasë, njeri që kisha simpati natyrisht. Po edhe shoktë tjerë kroat që ishin të klasës edhe ata kishin simpati.

Edhe dua ta theksoj këtë si vlerë shumë e mirë, civilizuese. Edhe në mbrëmje shkonim këndonim te dritaret e... secili te e vetja. Shkojshim shoku me shokun, dy, tre veta me kitare. Sa kemi ditë na ne atë kohë me i ra kitarës, po ne jse kemi bo zhurum. Kemi shku te dritarja edhe ka dalë ajo te dritaret, për shembull na ka gju pak me ujë ose ndonjë lule. Mirëpo, nuk ka ndodhë për shembull të del prindi edhe... me pas shku te familjet tana aty gjaku. Po du me thanë, qy çfarë dallimi. Na shumë bukur, rrinim aty sa rrinim këndonim derisa lodheshim pak edhe secili në shtëpinë e vet. Domethanë kto janë ato vlerat, ato mbresat që s'mund t'i harroj edhe gjithmonë i kam theksuar me njerëzit që kam pasë kontakt edhe i jam mburrë me Janjevën. Ka edhe plot momente tjera.

Për mu, për shembull ka qenë shumë mbresëlënëse që e kujtoj, Janjeva është diçka tjetër tash. Veç po du me lidhë pse ka mbetë Janjeva tash ndoshta ju kanë spjegue një si anekdotë? Se a kërkutë edhe anekdota? Kinse paska ardhë Nastradin Hoxha në kohën e vet, ka ndëgju për Janjevën. Janjeva me xehtari, me metalurxhi janë marr me shkrimjen e metalit me shekuj. Nastradini thotë, "Do të shkoj në Janjeve". Edhe e takon ni bari në hyrje të Janjevës, jo atje në atë grykën po atje kah i qesim bagëtitë për kullosa e tjera.

Edhe e takon atë bariun me dele po bisedon Nastradini po merr informata për Janjevën prej bariut. I thotë bariut, "Unë e kom ni lakën..." thotë, "në vend të qisaj peme..." a dru a çka ka qenë që i ka pasë nën hijen e drurit delet. Thotë, "Une e kom e kom ni lakën, vetëm ni gjeth i laknës iu bon hije gjith ktyne deleve". Çuditet bariu thotë e pytë, "Nga je ti?" E thotë, "Une vi prej ni vendi..." ku ta di, "te na ka lakra të mdha" e tjera.

Mirëpo edhe në atë kohë meqenëse janë marr me metalurxhi, me metale e tjera kanë ndërtu edhe kaca a kumeditë. Prej metalit... kanë bo shkrirjen e metalit edhe kanë prodhue kso prej bakrit, mbulesa për kishë edhe për xhamia janjevasit. Edhe sigurisht, kanë punu me çekana e tjerë edhe osht' ndëgju zhurma. Tash po i intereson Nastradinit, thotë, "Allahile..." thotë, çobanit, bariut i thotë, "Çka osht' kjo zhurmë e metaleve" e thotë, "Kjo zhurëm ka t'boj me laknën tane. Ata e përgadisin..." thotë, "ni kacë të madhe edhe atë laknen tane t'madhe e fusin turrshi në këtë". Edhe kinse paska thanë Nastradini, "Metsh as fshat, as qytet".

Kjo është interesant besoj. Edhe Janjeva ka mbetë tani as fshat as qytet. Ka qenë qytet, ka qenë qytezë në mesjetë e deri vonë domethanë në kohën e Turqisë e tjera. Mirëpo, sidomos me shkuarjen e kroatëve pas luftës në Kroaci që u bo me Serbinë... pat' shku Šešelji ndoshta ju kanë tregu për këtë. Šešelji ka shku i ka kërcënue... Šešelji u shku me paramilitar, "Ne kemi me ju kallë, kemi me ju djegë, kemi me ju bo..." kështu anena-knena. Edhe brenda javës katër mijë e sa njerëz kanë shku, i kanë lshu shtëpiat edhe sot e asaj dite ka mbetë shkret gati. E keni pa çfarë gjendje.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Dashta me ju pytë për institucionet në Janjevë. A ju kujtohen, a ka pasë ndonjë institucion? Për shembull, Shtëpia e Kulturës...

Emin Bikliqi: Po ka qenë Shtëpia e Kulturës, po. Në kohën time ka qenë shtëpia e kulturës. Ne kemi pasur... kemi shikuar filma, domethanë kohë pas kohe vinin me projektor, në atë kohë projektor ka qenë. M'u aty te zyrja e Skenderit, aty ka qenë ni mur qaty më kujtohet... qaty edhe tregu mbahej edhe me projektor na tregonin filmat. Tregonin filmat... ka qenë ajo salla e kulturës, s'ju kanë tregu ku ka qenë?

Anita Susuri: Përafërsisht...

Emin Bikliqi: Aty tash jeton ni rom, afër postës. Postën p'e dini?

Anita Susuri: Po.

Emin Bikliqi: E ngjit me postën... është shkatërru ajo. Ka qenë sallë e madhe m'kujtohet aty kemi mbajtë recitime si nrxanës, programe në atë kohë. Domethanë vitet '60-ta, '56, '57, '58, '60. Unë deri në vitin '62 kam qenë aty. Domethanë, këtë periudhë unë që e mbaj në mend këto kanë qenë. Ka pasë Shtëpi Kulture, ka pasë edhe rrymë ni kohë mas luftës, aty kanë pasë gjenerator për disa... për Shtëpi të Kulturës e di e tjera e tjera. E pastaj kur është elektrizue ma vonë... Mirëpo, pjesërisht ka pasë rrymë me gjenerator, unë që e mbaj në mend domethanë ma shumë se 50 vjet.

Anita Susuri: E ndërtesa e komunës a ju kujtohet?

Emin Bikliqi: Ndërtesa e komunës po, policia ku është sot... ngjitë me policinë në anë të djathtë i bjen. Tash çfarë shtëpie nuk e di po ngjitë me stacionin e policisë ka qenë komuna, mu që m'kujtohet.

Anita Susuri: A ju kujtohet a ka pasë edhe ngjarje tjera kulturore ose aktivitete që janë mbajtë në atë kohë? Që keni marrë pjesë ndoshta edhe ju...

Emin Bikliqi: Po, sportive po. Si nxansa vraponim e tjera, këto normal në kuadër të programit shkollor. Tjetër diçka që vlen... dasmat kanë qenë shumë interesante. Interesante te kroatët, me të thanë të drejtën na ju kemi lakmue se i kanë pasë kushtet ma të mira me muzikë e me valle edhe me mënyrën e manifestimit të dasmës. Ata dilnin nëpër rrugtë e Janjevës. Te na, te muslimanët për shembull, muslimanët në përgjithësi shqiptar, turq... domethanë, mrena. Gati sot e kësaj dite na kanë mbetë, po kemi fillu tash nëpër restorante, nëpër shtëpia janë manifestu. E te kroatët ka qenë e kundërta, edhe në shtëpi mirëpo kanë dalë edhe rrugëve. Me nusën kanë shëtitë nëpër rrugtë e Janjevës edhe kanë shkue në kishë edhe aty bojnë ceremoninë, ceremoninë e fejesës, martesës, kurorëzimit e krejt në kishë. Domethanë kisha ka qenë nifare strumbullari për shumë aktivitete, domethanë edhe për dasma çka kanë qenë interesant edhe veshja e tyne, llojllojshmëria, begatia, materiale e tjera, e tjera.

Anita Susuri: A kanë ngjasu veshja e tyne edhe me veshjen e...

Emin Bikliqi: Interesant osht' se çdo të thotë ndikimi i ambientit, ku jeton njeri ambientohet edhe merr kultura. Na kem marrë prej atyne diçka po edhe ata kanë marrë. Veshja e tyne ka qenë e

ngjashme gati me veshjen tonë, me dimija. Thu po qysh kroat e dalmacia? Po ndikimi i kulturës osmane sigurisht ka ndikue. Ata për dallim i kanë pasë pjesët e fundme të dimive me ni shtesë ma të ranë si të qëndisura. Edhe sot e kësaj dite në Prizren mund t'i vreni ato si dimija si... domethanë kryesisht kanë qenë me dimija. Edhe kto pjesët e tjera të ngjashme me veshjet e nuseve tona, shkurt tona.

Anita Susuri: Çfarë ndikimi tjetër në kulturë ka pasë ai... domethanë periudha osmane, kultura turke. A ka pasë tjetër ndikim?

Emin Bikliqi: Po ka pasë ndikim, domethanë aty ka pasë marrje edhe dhanie, domethanë marrëdhanie të vlerave kulturore, civilizuese. Unë në fillim ju thashë aty osht' bo gërshetimi i tri civilizimeve, domethanë ndikimi bezantin, ndikimi romak. Se kta kanë marrë kulturën romake prej Dalmacisë e prej... kulturën romake edhe civilizimi osman. Civilizimi osman ka ndikue, çka kanë bo? Për shembull, për ushqime sigurisht që kanë pasë ndikim edhe disa momente tjera. Në veshje po, në disa organizime po, domethanë ka pasë ngjajshmëri që e tham. Për shembull, te veshjet me dimia. Te kroatët nuk ka, në Zagreb e Kroaci çfarë dimija, s'dijnë çka janë. Po kto ndikimet e kulturave kanë ndiku te tjetra, kanë marrë kanë dhanë janë gërshetue, kanë ba edhe vlera të përbashkëta e tjera.

Anita Susuri: Sa i përket infrastrukturës, stilit të atyne shtëpive a ju kujtohet si kanë qenë?

Emin Bikliqi: Paj, zakonisht, zakonisht shtëpi po, ni katëshe, dy katëshe, dikund ndoshta edhe tri katëshe. Kanë qenë me veranda, p'e dini? Ose kanë qenë me, me ni pjesë të qitur jashtë të katit të dytë. Edhe stili i ndërtimit nifarë kombinimi osmano...

Anita Susuri: A ju kujtohet ndonjë shtëpi që ju ka lanë mbresa shumë, për shembull që është dokë interesante atëherë?

Emin Bikliqi: Po në Çarshi ndoshta e keni pa ni ndërtesë aty? I shkrun edhe viti i ndërtimit, ajo m'ka lanë pak mbresë po ajo...

Anita Susuri: Ka qenë kafene ajo m'duket?

Emin Bikliqi: Po ka qenë aty, shitore une sa e mbaj në mend, kanë qenë shitore moti, mandej kafene po kanë ndrru destinimin. Ajo ka qenë interesant edhe afër xhamies ni shtëpi është edhe sot e kësaj dite, e ka pasur edhe kryqin deri vonë. Ni shtëpi dy katëshe, tri katëshe i stilit të ndërtimit, po, orientalo domethanë, dalmatin a.... Domethanë, ka pasë ndikime edhe në ndërtim. Kjo fryma orientale edhe është gërshetu me ktë romake të vjetër.

Anita Susuri: Po është edhe ni kullë m'duket aty?

Emin Bikliqi: Po ju ka shpjegu Skenderi për atë.

Anita Susuri: A keni ndonjë kujtim rreth asaj kulle?

Emin Bikliqi: Jo unë nuk kam pasur, një herë kam qenë në atë kullë. Ajo është e trashëguar prej të parëve tanë. Kroatët e kanë trashëgu, tash n'cilin vit nuk e di. Domethanë, e kanë shitur tantë, se tantë kanë fillu të shkojnë për Turqi, domethanë pas luftërave ballkanike, sigurisht mas luftërave ballkanike e kanë ble kroatët. Kroatët kanë qenë ma të pasur. Kanë pasë mjete financiare edhe e kanë ble, po ata e kanë ndërtue të partë tanë. Skenderi sigursht iu ka folë për këtë.

Anita Susuri: Jo dhe aq. Për formën brenda diçka?

Emin Bikliqi: E kam harru, e kam harru. Unë kam qenë si fmi, kam shku diçka të kërkoj baba m'pati dhanë si detyrë te ai pronari diçka. Kom hy me ni dhomë, po m'u ka dokë shumë interesant ajo në krahasim me këto ndërtimet që i kemi pasë në shtëpitë tjera në Janjevë. Ajo është e veçantë edhe sot është e veçantë. Osh't' e lartë edhe stilit i ndërtimit taman kullë.

Anita Susuri: Çka mundeni tjetër me na tregu për Çarshinë e Janjevës?

Emin Bikliqi: Çarshia e Janjevës... ajo, aty ka qenë gjallni, Çarshia kështu kanë thanë edhe tjetër me të vërtetë ka qenë ni kand i mirë edhe gjithmonë sikur ka qenë festë. Për arsye se kta tregtartetë shkonin nëpër Jugosllavi dhe kur vinin, vinin me para edhe gjithmonë... muzikë po, kangtarë po aty, pije po edhe çka osht' që vlen të përmendet sidomos te kroatët? Ka ardhë ndonjë i hujë në atë Çarshinë që po më pytni. Ka ardhë ndonjë i hujë se kanë njoftë osht' ulë në atë kafenenë aty kroatët, shqiptarë e turqi kanë pi knej, ai i vetmuar i kanë thanë, "Ni kafe ose ni pije tjetër për mysafirin" edhe ai ka ardhë janë njoftu e janë falenderu e tjera, e tjera. Domethanë, mikëpritja ka qenë vlerë.

Ka qenë, tash sa ka mbetë kanë ndryshu gjërat. Po edhe tash është, tash kur të vijnë për shembull kroatët prej Zagrebit... që janë lindë vijnë kohë pas kohe i kanë do festa Shën Kolli, 1 qershor a s'di kur vijnë... me 10 a 12 kom harru, ata qarrosin. Kta që si njohin e i njohin kur janë aty. Po në atë kohë, Çarshia, Çarshia ka qenë gjallni deri vonë. Deri në ora 12:00 ka pasë gjallni në vitet... merreni me mend vitet e '60-ta e për ma vonë mandej edhe kushtet kanë qenë ma të mira, osht' aktivizu edhe ma shumë.

Metallski, ndoshta për Metallskin ju kanë tregue qysh kanë fillue. Niherë e ka pasë emrin Edward Kardelj ni fabrikë, ajo ka qenë afër postës aty, ndoshta ju kanë tregue, tash nuk e di. E masanej është bo ndërtimi i fabrikës dhe emrin e ka ndrue në vend të Edward Kartel... ju e dini kush është Edward Kardelj nga historia jo? Bashkëpunëtori numër një i Titos, slloven ka qenë. Po, po slloven ka qenë. Ai ka qenë ideolog, ideolog për ndërtimin e shoqërisë socialiste ose posaqërisht që i themi socialiste, vetëqeverisje në Jugosllavi. Domethanë, ai i ka dhanë ato orientimet dhe drejtimet ideologjike dhe politike për zhvillim edhe kanë shku hap pas hapi në demokratizimin e shoqërisë. Edhe ai ka pasë koncepte po ai vdiq. Mandej u panë ndryshimet mas viteve të '80-ta.

Ai ka pasë koncepte të ndërtimit të Jugosllavisë në ecje e sipër. Ni, ni zhvillim edhe ekonomik edhe kulturor edhe politik e tjera e tjera. Jo, si sistemet socialiste Shqipni, e Bullgari e Bashkimi Sovjetik, ato as që i kanë përngja sistemit tonë. Ndoshta kjo është çashtje tjetër, domethanë ai ka qenë ni

sistem, shembull, qysh duhet të zhvillohet në shoqni në çdo pikëpamje. Kur u përmed Kardelji, ai ka qenë një prej shtyllave kryesore të ndërtimit të shoqnisë në pikëpamje politike, ideologjike dhe shoqërore. Ai i ka dhanë drejtimet dhe ka shkru libra. Ato janë aprovu pastaj në Komitetin Qendror të partisë ose të Lidhjes Komuniste, ma vonë që i kemi thanë e tjera, e tjera.

Edhe në atë kohë ka shku Jugosllavia me hapa shumë të shpejtë edhe ne, domethanë prej viteve të '70-ta, viteve të '80-ta kemi shkue... ata kanë shku shpejtë na kemi shku edhe ma shpejtë për t'i nxanë tjetër. Mirëpo, janë bo ndryshime çfare janë bo... mirëpo na në atë periudhë dhjetë vjeçare, ajo periudhë ka qenë mjaft e rëndësishme për... domethanë kur po flasim për Janjevën po flasim për krejt Kosovën shumë e randësishme për zhvillim të gjithëmbarshtëm me shkollim, me kulturë me të gjitha.

Edhe në atë kohë njerëzit kanë ardhë, janë shkollu, kanë marrë bursa, kanë marrë kredi, janë dhanë mundësitë për shërim... për këto sene keni ndëgju ju prej tjerëve. Ajo ka qenë mrekulli, sistemi ka qenë i tillë, sistemi... e ka pagu për shembull, nëse s'ka qenë në gjendje të operohet në Prishtinë ia kanë pague klientit të gjitha harxhimet që i ka ba. Nëse s'ka pasë për shërim, për operim ktu e kanë dërgu në Gjermani, në Francë, në Angli me përcjellës, ia kanë pague plus edhe të gjitha harxhimet.

Kjo është tash për juve t'ritë që s'e keni përjetu doket si përrallë, si andërr, por kjo është e vërtetë. Kjo vetëm në aspekt. Ose kur është fjala e lirisë, e demokracisë ne... mu m'kujtohet, ne shkonim në Turqi për maj dy herë në vit shkonim. Edhe në deti edhe në... kur vishim në kufi në Bullgari, Jugosllavi lodheshim gjysë nate t'u pritë në kufi anej knej edhe vetëm skejoheshim dy metra prej rrugës edhe flinim, ni batani qaq kemi qenë pa frikë që thojnë. E sot është në çashtje tjetër (qeshë). Nejsë ajo është aspekt tjetër kjo nuk është interesant për ju.

Anita Susuri: Dashta me ju vet për shkollimin në Janjevë, domethanë kur keni qenë ju nxanës. A ka pasë shumë nxansa? A ka pasë ma shumë djem a vajza? A keni ndonjë kujtim, na tregoni pak për këtë?

Emin Bikliqi: Vajza krejt pak, domethanë katër klastë e para të katër-vjeçares krejt pak. Meqë vazhdum në paralelet kroate, asnjë vajzë shqiptare. Shumë lehtë ke mujtë me u dashuru në ndonjë kroate. Qaty me ni bankë ose me ni klasë e tjera e tjera (qeshë). S'kemi pasë, s'kemi pasë kontakte me vajzat e tjera aq shumë. Domethanë, shkollimi, zine i vajzave ka qenë në minimum ose asni nxanëse në klastë e larta të tetë-vjeçares. Në atë kohë s'kanë mundur ta marrin me mend me dërgu vajzën muslimane... kur them muslimane do të thotë shqiptare, turke e tjera, në paralelen kroate në atë kohë. Sot, po edhe sot, a din, me çu vajzën shqiptare me ni paralele {rrudhë krahët} e le më në atë kohë. Domethanë, shkollimi ka qenë në nivel jo të kënaqshëm. Unë i kom pasë shtatë motra, unë kom shku mas, pas Normales... po kjo nuk ju intereson, kjo pjesë e jetës time?

Anita Susuri: Jo, po. Po, po çkado që doni ju me nda.

Emin Bikliqi: Nejsë, hajde ta kryjna nihere me Janjevën pra. A keni ndonjë pyetje tjetër?

Anita Susuri: Po. Edhe deshta me u lidhë masi jemi te shkolla, kjo ka qenë karakteristike vetëm për femrat kroate që janë shkollu ma tutje apo vetëm shkollën fillore e kanë...

Emin Bikliqi: Jo, jo. Në përgjithësi, ndoshta ju kanë thanë edhe bashkëbiseduesit e tjerë, kroatët nuk kanë qenë të orientuar për arsimim. Ata i kanë pasë zejet e veta, burimet për jetë. Gati asnjë prej tyre nuk e ka vazhdu shkollimin, gati. Munesh... as gishtat e një dore nuk munesh t'i numërosh për shembull ata që e kanë vazhdu shkollimin. Mu që më kujtohen prej gjeneratës time, krejt dy vetë kanë qenë... dy tre vetë që kanë ardhë në shkollë të mesme, tjetrtë jo. E vajzat edhe ma hiç. Edhe te kroatët, domethanë, po ata në përgjithësi kroatët nuk kanë qenë të orientuar për arsimim. Për zejtari po, pare kanë pasë, tregti kanë bo edhe ka qenë e knaqshme.

Anita Susuri: Si ka qenë me u rrit në Janjevë si fmi, pasi që thojnë se ka pasë shumë fëmi. Familjet kanë qenë me plotë fëmi. Si ka qenë kjo? A ka qenë vetëm te kroatët apo...

Emin Bikliqi: Jo, ajo ka qenë dukuri edhe te, edhe te tjetrtë. Por, te kroatët ka qenë e shprehur ajo. Po ata kanë qenë të privilegim, të them në thojza të privilegim, të kenë edhe 13, 14, 15 fëmi. Ndoshta ju kanë tregue? Deri në 15 fëmi se i kanë pasë kushtet. Edhe te na kanë shku me shumë fëmi... unë për shembull vet i teti, shtatë motra dhe ni vlla. Po edhe plot familje tjera, minimumi pesë. Domethanë, deri në dhetë fëmi, njëmbëdhjetë fëmi tanët, po e te kroatët ka qenë e shprehur deri në 15 fëmi. Aty ndoshta edhe kisha ka ndiku pak a shumë. Edhe në islam qishtu, gjithmonë kanë ekzistue për shembull sa ma shumë fëmi të keni, fëmitë janë pasuri e ku ta di. E kroatët, po edhe kta e kanë pasë interesin e vet, kombëtar të qenies t'vet që t'kenë sa ma shumë kroat, e natyrshme.

Anita Susuri: Pas shkollimit në Janjevë si ka vazhdu shkollimi ju?

Emin Bikliqi: Unë në vitin shkollor '62, '63 jam regjistru në Normale edhe kur kam ardhë në Normale ka qenë dashtë të ipet provimi pranues edhe ni... komisioni ka qenë i përbashkët shqiptar-sërb për pranimin e nxansave. Matematikë, gjuhë, muzikë, edukatë fizike kto kanë qenë ato që me pa a do të jetë ky mësues me perspektivë në të ardhmën, a ka vesh për muzikë, se duhet t'ju mësoj nxënësve për instrumente ose këndim, për gjuhë e matematikë e tjera. Edhe ni profesor, Mithat, gjallë është ende p'e sheh Bikliq po thotë, "M'fal..." thotë, "ti..." po, "çka po m'pytë anej knej". Unë p'i tregoj sikur me ju që po bisedoj. Edhe thotë, "Mirë..." tha. Unë p'i thom, "Unë po du në paralelen sërbe". U çudit profesori. "Po qysh..." tha, "ti në paralelen sërbe", "Profesor, unë..." kështu kështu po ia spjegoj sikur juve që ju tregova, "i kom kry kto, kto". Ai, "Jo..." thotë, "ti mirë p'e flet shqipen. Jo more çfartë s'vjen në konsiderim. Gjuhën shqipe, regjistru në paralelen në gjuhën shqipe".

Edhe unë shpejt e përvetësoj se ka ndiku pak a shumë ajo periudhë, gjuha në gramatikë e tjera. Pastaj unë e kom pasë fatin se i kom pasë profesorët e mirë, Rexhep Hoxhën, s'di a ju kujtohet "Lugjet e Verdha"? Atë e kom pasë profesor të gjuhës shqipe edhe une për ni kohë të shkurtë e kam përvetësu gjuhën letrare, gjuhën letrare. Edhe pastaj ajo m'ka ndihmu në jetë, Rexhep Hoxha. Mandej edhe leximi edhe profesorët e tjerë edhe sot unë, tash mburrem unë me drejtshkrimin tim. Une shkruj, besoj mirë nuk ia lshoj rrugën ni gjuhëtari për drejtshkrim. Ndryshe njeri kur flet edhe ndryshe kur shkrun. Kur shkrun je ma i kujdesshëm edhe i respekton të gjitha. Gjatë komunikimit njeri tash mund të bëjë gabime.

Tash ne kemi mbetë as me gjuhën e unifikuar as me... a është qashtu? As me këtë gjuhën që e përdorim. Si gjysë... në të vërtetë letrare dhe gegnishtja. Janë perzi tash gegnishtja me gjuhën e unifikuar, na nuk p'e respektojmë. Kryesisht nuk p'e respektojmë, domethanë me gegnishte e tjera po e mira e s'mirës është që norma e gjuhës duhet të respektohet në pikëpamje sociologjike e kto, do të thotë që gjuha është element i randësishëm si shenjë e unifikimit të kombit. Kur e flet ni gjuhë njejtë, atëherë ajo është faktor shumë i randësishëm për bashkim.

Bojnë kaniehere shaka thonë, "Shkojnë në Shqipni, bisedojnë kta..." njerëz që nuk janë shumë të arsimuar, është çashtja e fjalorit, "Allahile a ma përkthen ti?" Biseden e ni shqiptari të Kosovës e atij të Shqipnisë i thotë, "Unë s'pe kuptoj kta spjegoma" (qeshë) me fjalë të tjera çka po m' thotë. Domethanë ai momenti i gjuhës. Normalen e kam kry, kam qenë dy vjet kryetar i rinisë. I kemi thanë Komiteti Shkollor i Rinisë...

Anita Susuri: E si ju është dokë Prishtina kur keni ardhë atëherë?

Emin Bikliqi: Prishtina qytet. Qytet e....

Anita Susuri: Çfarë përshtypje ju ka lanë?

Emin Bikliqi: Po si qytet... po unë në Prishtinë kam ardhë, ne kemi bo tregti me Prishtinë. Janjeva ka bo tregti. Kem pasë pemë zakonisht edhe kem sjellë për shitje, kem pasë mandej lidhjet familjare, nuk ka qenë ambient i panjohur. Ni ambient pak a shumë në të cilin jom përshtat shumë shpejtë. Edhe Normalen e kam kry, pas Normalës kam regjistru Fakultetin e Shkencave Politike, grupi i sociologjisë në Sarajevë. Atje e kemi formu Klubin e Studentëve, qe kjo është ajo librezë {tregon me duar}. Edhe ka qenë masandej Klubi i Qytetarëve Shqiptar "Bajram Curri" na i kanë dhanë lokalet. Shkurt boshnjakët na kanë ndihmu në çdo pikëpamje edhe na kanë thanë vetëm kërkoni, ndashi objektin, ndashi sallën, na patën mundësu me ble libra, me sjellë prej Kosovës libra, bibliotekë ku do të mund të tuboheshin shqiptarët në Sarajevë. 20 mijë kanë qenë në atë kohë, unë kur kam qenë në studime.

Domethanë, unë kam shku në vitin shkollor '67/'68 edhe në atë kohë jemi organizu kemi mbajtë koncerte e tjera e tjera. Edhe në fakultet unë vitin e parë e kom kry shkelqyeshëm, kom marrë shenjën e argjenditë çdo vit. Nxënësit, studentët e shkëlqyeshëm kanë marrë prej rektoratit, prej universitetit të Sarajevës shenjën e argjenditë edhe në fund e kam arritë suksesin e shkëlqyeshëm edhe e kam kry, zine, për tri vjet e gjysë. Edhe e kom marrë shenjën e artë të Universitetit të Sarajevës. Edhe kam qenë demonstrator i mësimit, s'di ju a keni pasur demonstrator të mësimit? Domethanë, unë kam qenë nifarë ndihmësi i asistentit si student edhe kam marrë rrogë.

Ni vit kam marrë rrogë si student që e kam ba plotësimin e mësimit të ni dege të sociologjisë. Edhe ata profesorët e sociologjisë kanë qenë të interesuar të mbetëm unë në Sarajevë, kom pasë suksesin e shkëlqyeshëm. Më kanë ndihmu ato, katër vitet kroatisht që i kam kry për gjuhë edhe nuk kam pasë problem. Domethanë, lirisht kam ligjeruar në fakultetin tim për kolegtë e mi në gjuhën serbo-kroate, i kemi thanë në atë kohë. Edhe m'patën ftu për me i vazhdu studimet, shtatë motra i kisha ma tepër lakmoja t'vi t'ju ndihmoja e tjera, e tjera. Nejse, kjo është ni çashtje tjetër.

Pjesa e Tretë

Emin Bikliqi: Unë e mbaj në mend si fëmi, thonë lepuri ka hy në Janjevë ka dalë në Gadime. A ju kanë spjegu këtë?

Anita Susuri: Po, po na spjegoni edhe ju s'ka problem.

Emin Bikliqi: Ne e kemi pasur ni copë mal edhe ni vneshtë në hyrje të Janjevës. Ajo... asaj pjesës i thonë Zhabicë, s'di ajo s'osht' me randësi. Ajo kodra, dy kodra të mëdha ajo ngushtica ma e madhe. Në anë të djathtë na e kemi pasë ni mal edhe me vneshta edhe unë si fëmi kur shkoja në vreshtë kaloja aty edhe ka qenë ni zgafellë. Edhe si fmi afrohesha aty, ka qenë e fellë ajo, merrja nga një gur edhe e gjuja atje edhe dëgjojsa zhurmë sikur të llamarinës. Edhe në atë kohë unë, domethanë kanë qenë vitet e '60-ta përafërsisht, kto që i mbaj në mend që kam shku e tjera. Edhe tregonin thoshin, "Lepuri ka hy në atë zgafellë edhe ka dalë në Gadime".

Edhe dulë pastaj e vërtetë viteve të '80-ta gati që e zbulun atë Shpellën e Gadimës edhe spjegimi... kjo paska lidhje me Janjevë. Domethanë diçka ka qenë e vërtetë, diçka njerëzit... domethanë lepuri ka hi se e ka ndjekur qeni, zagari a çka i thonë edhe lepuri paska dalë në Gadime. Tash... po kjo u vërtetu pastaj me zbulumin e kësaj edhe spjegimet e njerëzve mas 50 vjete gati. Kështu që, ni moment interesant. Masandej e keni pa në atë kodrën e madhe në hyrje të Janjevës në të majtë, aty e kanë rrimi atë dheun ato zgafellat e kohëve të romakëve, kur osht' nxjerrë xehja. Tjetër, tjetër s'po di çka ia vlen. Pytni ju, nuk po di tash.

Anita Susuri: Tash ishim te Shkolla Normale, a keni qenë ju i vetmi që keni vazhdu nga Janjeva? E kam fjalën prej gjeneratës t'juj.

Emin Bikliqi: Po, po. Mas meje mandej kanë ardhë kryesisht, po kanë ardhë ma vonë po zine që i pari jam.

Anita Susuri: E pse vetëm ju keni vazhdu?

Emin Bikliqi: Po, kumeditë. Unë për veti, unë për veti çka po di. Unë i kam dhanë rëndësi shkollimit. Domethanë, mixhën e kom pasë unë në atë kohë ai ka punu në Beograd, atë mixhën që e kom pasë në Gjermani, ai ka ardhë me... në kohën e Luftës të Dytë Botënore ka ardhë me gjermanët ktu edhe ktu e kanë vra serbët. Në Graçanicë ai t'u shku, ai ka qenë në uniformë. T'u shku për Janjevë e kanë vra, as nuk dihet ku është, nejsë kjo është histori në veti e tjera. Ashtu që ai e ka humbë jetën edhe nuk dijmë për të.

E mixha tjetër, ai ka qenë ushtar në Beograd në Spitalin Ushtarak edhe aty ka shërby si ushtar edhe e kanë nal ata aty edhe aty ka punu ai ni kohë edhe mandej ka shku për Zagreb mixha. Po du me e lidhë me atë se ai ka pasë ndikim. Nejsë, sado kudo edhe une kam qenë i interesuar për mësim po ndikimi

edhe i mixhës. Se ka jetu në Beograd, ka pa ndryshe jetën. A është qashtu? Edhe ai m'ka përkrahë. Kur vinte m'sillte diçka prej Beogradit edhe thonte, "Nëse mëson ti mund të vish nesër në Beograda ku të dush, mund të bëhesh mjek e tjera".

E kur e regjistrova Normalen, ni arsimtar i imi malazez ka qenë që m'ka dhanë mësim, fizikë, edhe m'pytë thotë, "Cilën shkollë e regjistrove?" Them, "Normalen" thotë, "Normalja për ty... " m'pat' thanë në gjuhën serbo-kroate, s'pe them në gjuhën serbo-kroate, p'e përkthej në gjuhën shqipe. Ai thotë, "Koll i macës është për tye," tha, "ni shkollë teknike a..."

Anita Susuri: Diçka e lehtë.

Emin Bikliqi: Po unë lakmova, unë lamova në Normale për shkak të bursës. Në atë kohë komuna kishte nevojë për mësimdhënës, për mësues, arsimtarë edhe jepnin bursa. Edhe ajo ka ndiku te unë që të regjistrohem në Normale. Ndoshta ma mirë do të ishte të isha regjistru në Shkollën Teknike, e tjera. Sidoqoftë, ajo ka kalu.

Anita Susuri: Po në Prishtinë si keni jetu? Si kanë qenë kushtet atëherë?

Emin Bikliqi: Po mirë, unë privat kam... kam pasë bursën edhe domethanë ni jetë modeste. I kam plotësu nevojat e mia për jetesë e për libra e për fletore e për gjërat që kanë qenë të nevojshme.

Anita Susuri: A ka qenë ndonjë vend i caktun ku kanë jetu kta nxanësit, studentat?

Emin Bikliqi: Po, në konviktin e Normalës. Unë nuk kam banu në konvikt. Kam pasë mundësi po kam preferu ma shumë banimin privat. Kam banu ktu në qytet, në Rrugën e Nishit i thojnë te tjegulltorja. Tash ndryshe e ka emrin me siguri, nuk e di. Aty kam banu te ni familje prishtinase, pak kemi pasë ni lidhje me ta miqësore. Vetëm ni plak e ni plakë kanë qenë. Unë kam banu te ta edhe bukur e kam kalu. Katër vjet m'kanë konsideru si fëmi të tyne. Për arsye se zgjohesha për me shku në mësim, ua nderzsha shporetin, çajin e bojsha gati e kur u çojshin ata të gatshme, çaji i gatshëm. Unë shkoja për shkollë ashtu që ata gati më birësun mu. Po du me thanë, mirë e kom kalu e ata me mu mirë edhe unë me ata mirë. E kështu ka qenë.

Anita Susuri: A ka pasë dalje në atë kohë? A keni dalë në qytet apo ju kujtohet?

Emin Bikliqi: Ku në Prishtinë a?

Anita Susuri: Po.

Emin Bikliqi: Po more sa dashnia e sa eihhh.

Anita Susuri: Na përshkruni pak këtë kohë. Atë kohë na përshkruni pak si ka qenë.

Emin Bikliqi: Në çfarë aspekti?

Anita Susuri: Në çdo aspekt, si doni ju.

Emin Bikliqi: Po, Prishtina ka qenë...

Anita Susuri: Për daljet, për jetën...

Emin Bikliqi: Po të ipeshin mundësitë e ndryshme, a osht' qashtu? Për ni jetë ma të mirë. Mandej kontaktet me shokë e me shoqe. Shkonim në kinema në atë kohë, patjetër. Gjatë javës ni herë në kinema. Në fillim niherë jo telashet e mësimëve, dikur masanena jo po të hin vetja në qef anej knej ndonjë vajzë e tjera, e tjera. Masandej filloi dashuria, e masanej u bo punë e madhe (qeshë).

Anita Susuri: Si ka vazhdu pastaj, domethanë pas Shkollës Normale meniherë keni shku në Sarajevë?

Emin Bikliqi: Po, meniherë.

Anita Susuri: Si ka ndrru kjo na tregoni.

Emin Bikliqi: Unë kam qenë i interesuar ta studioj psikologjinë edhe shkoj në Zagreb... paraqitem, se edhe mixhen e kom pasë atje ju tregova. Unë suksesin e kisha të shkëlqyshëm e tjera. Por m'thanë, "A ke siguru bursë? Vetëm ata që e kanë të sigurume..." se ashtu ishte ajo dega e psikologjisë me numër të kufizuar të studentëve. Ajo ishte ni kusht që une nuk e kisha dhe u orientova pastaj me disa shokë të tjerë edhe shkum në Sarajevë. Edhe shkova në Sarajevë, regjistrova Fakultetin e Shkencave Politike, atë e kreuva.

Anita Susuri: Kur keni udhëtu për herë të parë jashtë Kosovës edhe kur keni shku çfarë përshtypje ju ka lanë ai vend?

Emin Bikliqi: Për herë të parë kemi shku si shkollë tetë-vjeçare në Ohër.

Anita Susuri: Prej Janjevës?

Emin Bikliqi: Prej Janjevës në Ohër na kanë çu.

Anita Susuri: A ka pasë organizime të tilla shkolla?

Emin Bikliqi: Po, ka qenë për mu interesant. Kemi shku mandej në Beograd, shkolla fillore, si shkollë fillore kemi shku në atë kohë. Kto dy vende i kemi vizitu në atë kohë, në tetë-vjeçare sa kam qenë. E Normalja pastaj, Normalja ka qenë tjetër muhabet.

Anita Susuri: E në shkollën fillore në Janjevë, a kanë shku të gjithë nëpër kto organizime apo ka pasë veç të caktum që kanë shku?

Emin Bikliqi: Po, jo, për ekskurzione kemi shku të gjithë gati, besoj që shumica po. Ekskurzione si në Ohër, në Beograd, këtu nëpër Kosovë po, në Prishtinë po. Ka qenë Prishtina afër, pa problem.

Anita Susuri: E periudha e studimeve si ka qenë?

Emin Bikliqi: E studimeve ka qenë, për mu ka qenë pak intenzive. Ka qenë intenzive se unë doja ta kryj sa ma shpejtë edhe studentët e shkëlqyeshëm kishin të drejtë të hynin në provime pa i dëgjua provimet. Edhe unë provim pas provimi i kryjsa ma herët provimet edhe e kreu edhe fakultetin ma herët. Kështu që, e kom bo nifare vrapimi ta kryj sa ma shpejtë që për shkak të nevojave familjare edhe ajo tjetra mandej nevojat e Kosovës, kinse për kuadër e ku ta di, e tjera, e tjera.

Anita Susuri: Familjen a e keni kriju pas studimeve apo?

Emin Bikliqi: Pas, pas studimeve.

Anita Susuri: Shumë pas studimeve?

Emin Bikliqi: Jom punësue në Komitetin Krahinor të Lidhjes së Komunistëve edhe pas një viti kam shku ushtar në Prizren. Ka qenë shkolla e oficerëve rezervë, qishtu ka qenë. Çdo komunë e ka pasë nga disa. Edhe shërbim ushtarak edhe e kemi kry shkollën e oficerëve rezervë. Ata e kom kry edhe pastaj kom vazhdu punën në Komitetin Krahinor edhe... do të thotë në '73-tën, në vitin '72 jom punësu, '73 kom punu, '74, viti '74 m'ka shku ushtar. Si jom kthy prej ushtrisë jom martua.

Anita Susuri: Si jeni njoftu me zonjën?

Emin Bikliqi: Lidhjet e ndryshme, lidhjet e ndryshme. Unë kam qenë bukur i lëvizshëm edhe... tash se di, nuk është turp, thuhet njeriu e ka ni jetë po disa dashuri, s'osht' vetëm një e ni jetë e ka. Po kjo është ajo dashuria që kemi lidhë martesë e tjera. Kom pasë lidhje e njoftime. Në atë kohë shkonim pak edhe me garanca. Familja, personi e tjera, e tjera. Ashtu që gjitha ato kanë ndiku që të orientohe. Zonjën e kam nga Gjilani ashtu. Mos më pytni shumë se nëse dikun e lexon zonja ose e shikon masandej në pleqni pëlçet belaja (qeshë). S'bon me i tregu të gjitha.

Anita Susuri: Zhvillimi i juj profesional si ka vazhdu masnej?

Emin Bikliqi: Zhvillimi profesional nuk kam pasur fat aq shumë, shkurt të ju them kam punu për të tjetër ma shumë e jo për veti, në krahasim me shoktë e mi. Do të thotë, unë i kom pasë të gjitha paradispozitat të merrem me shkencë. Kam ardhë ktu, shtatë motra jam mundue për shkollimin e tyre, t'i bohem krah babës edhe u punësua në Komitetin Krahinor. Aty kam punue si thonë ni shprehje, argat për të tjerët. Me ju shkru referate, me ju shkru fjalime, raporte, analiza. Kto telashe. E unë s'kam ditë që duhet njeri për veti, për ngritjen profesionale. Mandej jo telashe e viteve '81-shi, problemet politike, Komiteti Krahinor ishte ajo epiqendra. Hajde këtë, hajde atë m'thirrnin, edhe në Beograd m'kanë thirrë me i vazhdu studimet mandej fëmijtë, obligimet edhe qishtu jeta. Me fjalë të tjera, për veti nuk kam punua.

Krahas punës kam ligjerue në Shkollën Politike të Lidhjes të Komunistëve i kanë thanë, nuk e dini ju këtë. Ajo ka qenë për puntortë e pa marrë parasysh arsimimin, me fakultet, e punëtor e tjera kanë ardhë në shkollën politike. Kanë delegu komitetet e komunave edhe ni vit kanë ardhë pa pagesë edhe unë kam qenë një prej ligjeruesve, krahas punës time që e kom bo kam ligjerue në atë Shkollë Politike deri në fund. Prej fillimit deri në fund. Si honorar e kom pasë atë punë.

Anita Susuri: E gjatë kohës kur keni punu, domethanë para viteve të '80-ta. A keni ndonjë kujtim që ju ka mbetë ashtu?

Emin Bikliqi: Para të '80-tave?

Anita Susuri: Po.

Emin Bikliqi: Ka kujtime të mira. Atëherë Kosova ka marrë hov në çdo pikëpamje të zhvillimit, edhe ekonomik edhe politik e kulturor e civilizues e të gjitha. Atëherë ne i kemi marrë këmbët si thonë, ne Kosova shqiptarët. Përndryshe, mas viteve të '80-ta veç kanë qenë trende tjera.

Anita Susuri: Cili ka qenë ai roli juj, domethanë gjatë trazirave të vitit '81, a keni marrë pjesë në demonstrata apo keni qenë më neutral?

Emin Bikliqi: Jo, jo. Unë nuk kam marrë pjesë atje se as që kemi guxu se ke mujtë me hupë me punë e me shku edhe në burg. Se unë kam punu në një institucion që ka qenë më i ndishmi, ai ka dhanë drejtimit... jo Komiteti Krahinor po në bazë të vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë në Beograd, ato kanë shku pastaj nëpër republika, nëpër krahina. Ashtu që, na, na s'kemi guxu aty kem qenë të kujdesshëm. Po vetëm ni moment është interesant... ka plot momente.

Domethanë, ajo kohë ka qenë kohë taman e zhvillimit e kënaqësisë shpirtërore të shqiptarëve në çdo hap me perspektivë. Ke regjistru shkollën, ke pasë mundësinë maksimale për punësim, je punësue, ke hy në regjistër atje edhe e ke ditë vendin tond kur ti munesh të vish te banesa. Domethanë, ka qenë demokracion i drejtpërdrejtë. Demokracionet janë të ndryshme dhe demokracia borgjeze osht', mund të marrim demokracitë e shoqërive të mëparshme. Secila periudhë i ka demokracitë. Mirëpo kjo që po flas e Kardelit e Titos, kjo e viteve '70, '80, kjo ka qenë ajo demokraci e drejtpërdrejtë, i kemi thanë socialiste. Pse? Se njeriu ka... njeriu punues ose njeriu në përgjithësi në Kosovë ka vendosë për fatin e vet.

Domethanë ke qenë i punësuar në atë kolektivin tënd ti ke votu, ke diskutu, ke propozu. Për rroga, ke diskutu për kushtet e jetës, për banesa, për pushime. Bashkë secili ka marrë pjesë edhe janë bo ren listat. Ti ke qenë subjekt, i themi në sociologji, subjekt ke qenë nuk ke qenë objekt. E tash për dallim prej asaj kohe tash ne jemi objekt. E ju ma së miri më kuptoni {tregon me duar} po edhe ju me siguri se çka domethanë ajo objekt e subjekt. Na jemi subjekt politik në katër vite ose para katër viteve kur bohen zgjedhjet edhe shkon voton, kurgjo tjetër. Kush t'pytë... kush më pytë mu. Prandaj na jemi në këtë gjendje se nuk jemi subjekt.

Domethanë. prej neve janë tjetërsu ato funksione. Dikush tjetër... na ja u kemi besu atyne. E tash po e shihni qysh ja u kemi besue edhe çka po na bojnë. Kjo nuk ka qenë e mundur në atë kohën time, në atë kohën e Kardelit. Na kem vendosë. Po du me thanë ajo ka qenë kohë e perspektivës. Njerëzit kanë qenë të knaqun. Je punësu e ke ditë ti vendin tond edhe ti do të fitosh banesën, do ta krijosh familjen tande edhe do të jesh i lumtur. Sot, bojmë pasuri... disa, a osht' qashtu? Mrena natës e mrena vitit e tjera e qysh e bojnë e ku ta di, me nderë e pa nderë nuk janë të gjithë me ni thes. Po, ju jeni dëshmitarë, s'kam çfarë t'ju flasë për të tashmën. Edhe krejt kto tonat janë të tjetërsume te ta, na ju kemi tjetërsu. Çka po thojnë për kuvend mandej? Mos t'i përsëris unë mendimet e vet deputetëve. Çka është ky kuvend? Kush janë kta njerëz? S'du të hi në atë temë.

Me fjalë të tjera po du me thanë se në krahasim me atë kohë, na kemi qenë subjekt edhe ke qenë i lumtur. Sot nuk është i lumtur edhe ai që ka miliona se p'e di qysh i ka fitue. A osht' qashtu? S'mund të jetë qenia e knaqun. Ka edhe raste, osht' ashtu që knaqen me vujtjet e tjerëve e tjera, e tjera. Po po du me thanë, në atë kohë na kem pasë kënaqësinë tonë. Edhe kur flas une me rininë sikur me juve që po flas tani për kto çashtje edhe për shumë çashtje të tjera, thonë, "A osht' e mundur që ka qenë kjo?" Po na jemi dëshmitar, është e mundur qysh s'osht' e mundur.

Për fëmijtë e mi edhe për ju kjo doket si prallë pak, a osht' qashtu? Si ni tregim që thu nashta ka ndodhë, po na e kemi përjetue, na e dijmë. Se ndoshta fola shumë une në këtë drejtim po masi m'pytët për me bo krahasim qysh ka qenë ajo kohë, ajo ka qenë kohë e perspektivës. Une bile e thoja shpesh, kur kemi qenë Amerikë na ke pasë pasaportën ke shkue ku të dush nëpër botë ku të dush. Sot çka? Qe sa vjet...

Anita Susuri: A keni udhëtu ju?

Emin Bikliqi: Kom udhëtu.

Anita Susuri: Ku keni udhëtu edhe çka ju ka pëlqy ma s'shumti?

Emin Bikliqi: Gjithkund kam shku. Kam qenë në vitin '73 në Berlin, kam qenë si aktivist i rinisë në atë kohë edhe kam qenë në delegacionin politik të rinisë së Jugosllavisë. Me vetura kemi shku republikat, ka tre katër delegat edhe të Kosovës kemi shkue 15 ditë kemi ndejtë në Berlin, Festivali Ndërkombëtar i Rinisë. Domethanë, rinia nga e gjithë bota përveç Shqipnijos që s'ka marrë pjesë në atë kohë. Të gjitha vendet e tjera kanë marrë pjesë. Me Ukshin Hotin, me Agim Zatriqin kam qenë në atë delegacion. Agimin ndoshta s'e njihni ju, ka qenë drejtor i televizionit, s'osht' me randësi. Ukshinin po. Me Ukshinin kemi fletë me ni dhomë e tjera, e tjera.

Domethanë, kam qenë në atë delegacionin, ajo ka qenë edhe punë zyrtare. Kam marrë edhe meditje. Kam shëtisë, kom pasë kontakte me rininë e botës e tjera, e tjera. Masnej. privatisht kam shëtisë prej Rumanisë e Bullgarisë e Greqinë ma shkojshim në kafe të shtunën e të dillen për qef, bie fjala. Përveç Shqipnjinë që s'kem mujtë me shku. Turqinë ma mos të flasim. Viteve të '70-ta si student kam shku për

herë të parë në Turqi, kam shku në Siri, në Damaskus se aty e kom pasë ni shok në Sarajevë që jom njoftu, arab.

Jemi njoftu e kemi pi çaj e kafe e kemi nejtë. Thotë, “A vjen në Siri?” “Vi”. Edhe shkoj une për Siri, në Damaskus une mysafir. Prej atuhit, “A shkojna për Liban?” “Po shkojmë”. Me taksi shkojmë në Liban, në Beirut. Në atë kohë i thonin Beirutit, Parisi i Lindjes. Masnej luftat e kto i dini, s’osht’ temë e diskutimit. Po du me thanë kto vende i kam shëtitur. E për Jugosllavi ma mos të flas. Në atë kohë s’di a ka vend të bukur e të randësishëm që se kam vizituar, zyrtarisht.

Anita Susuri: Deri në cilin vit keni punuar me postin që e keni pasë?

Emin Bikliqi: Po s’kom pasë une post aty kam qenë bashkëpunëtor profesional.

Anita Susuri: Në atë pozitë e kam fjalën?

Emin Bikliqi: Po deri në... deri ka qenë Komiteti Krahinor. Deri në fund të ‘89. E masandej me tregtia me çka kemi mujtë masandej. Ajo periudha, lloj lloj pune.

Anita Susuri: A ka qenë periudhë e vështirë ajo?

Emin Bikliqi: Ajo a? Jo e vështirë po tepër e randë, tepër e randë...

Anita Susuri: Na përshkruani pak?

Emin Bikliqi: Me shumë probleme, me shumë probleme. Lloj lloj... lloj lloj probleme. Të ekzistencës, politike, a do të burgosin, a do të vrasin e tjera, e tjera. Edhe krejt n’këtë pjesë, domethanë ‘90 deri ‘89... domethanë ‘89-ten djalin e dytë e kom pasë student të anglishtes ktu në Prishtinë edhe me shokë ata vendosin të shkojnë në afanzivën e parë në Prekaz. Edhe shkon në afanzivën e parë, kanë shku në uniforma të gatshëm për luftë e tjera. Mas tre katër muajve, tash ju kanë ra në gjurmë a nuk e di dhe i kanë nxanë krejt kta të ri si lepuj me Iljaz Kodrën, ata e kanë pasë komandant. Edhe i fustin në burg në Mitrovicë. Aty ka nejt deri me 10 qershor kur u tërhoq policia dhe ushtria sërbe. I morën prej burgut të Mitrovicës i çunë në Pozarevc.

Domethanë, tri vjet ka qenë burg, ka qenë i dënum shtatë vjet për iredentizëm e për terrorizëm. Janë fotografitë në gazeta, të tyne, të djemve. Shkrujshin gazetatat në katër antë të Beogradit për kta të ri. Terrorista e nejse të gjitha ato shprehje që i kanë përdorë. Edhe ajo ka qenë ni periudhë shumë e randë për mu. E randë se për shembull na nuk e kemi ditë... ma s’pari kur ka shku në Prekaz i shikonim lajmet, televizionin në mramje i tregonin, u vra filani, u vra, u bo kshtu, u masakru. E na me vesh në krah çka do të thonë për djalin, për djalin tim, shoktë ja njihja. Ajo ka qenë shumë e vështirë. Mandej kur i morën në burg, ajo... edhe ajo e vështirë, edhe ajo e vështirë.

Anita Susuri: A keni pasë kontakt me të sa ka qenë në burg?

Emin Bikliqi: Vetëm nëpërmjet avokatit. Me të thanë të drejtën disa avokatë janë sillë shumë keq. S’du me emra t’i përmendi po na kanë marrë para t’u premtue, i lirojmë, e si avokat mo. Edhe njëri prej avokatëve të njoftun ka qenë ai... më kujtohet si sot, na t’u pritë aty me avokat... na shkonim me avokatin ai hynte në bisedë e na tregonte qysh është gjendja e fmiut tonë, e djalit e të tjera. E njëri t’u bo marrëveshje, “Dhjetë mijë euro paraprakisht”, s’du me ia përmend emrin, avokat i njoftun i ndërë është. M’ka lanë shumë përshtypje të keqe. Edhe nejse, ajo ka kalue. E shkun në Pozharevc e atje i kanë malltretue, ajo djegia e burgut, sekondat i kanë shpëtue. Krejt ato momente janë që i kanë lanë trauma n’mu e në familjen time e tjera e tjera. Ka qenë jo e randë po sa vdekja e qishtu.

Anita Susuri: Çfarë lidhje ju ka mbetë juve me Janjevën? A shkoni shpesh?

Emin Bikliqi: Në Janjevë e kam shtëpinë. Po nuk jam i lindur aty se atë e ka ndërtue baba ma vonë në vitet e ‘70-ta e ka ndërtue. Po aty e kemi pasë kopsht edhe vreshtë. Shtëpinë masandej baba që e ka ndërtue. Prindtë m’kanë vdekë, motrat janë martue. Unë në Prishtinë, shtëpia është aty me të gjitha paisjet që duhen për ni jetë normale. Me ujësjellës, me telefon, me krejt. Shkoj kohë pas kohe, verës shkoj ma shpesh. Siç e patë, dalë pij ka ni kafe, takohem me kusheri, me shokë. Punoj nga pak aty ndonjë aktivitet herë vreshtë, të kopshtit e tjera. Edhe ajo m’duket tash në kohën e penzionimit interesant.

Anita Susuri: A keni qenë prezent ndoshta në atë kohën kur kanë fillu me u largu kroatët?

Emin Bikliqi: Jo, nuk kam qenë une aty.

Anita Susuri: Të viteve të ‘80-ta.

Emin Bikliqi: Nuk kam qenë. Po i përmendët vitet ‘81, ndoshta nuk ju konvenon kjo mënyrë herë ‘81, herë ‘70 e, po e kom ni përvojë shumë të hidhur të asaj periudhe kur janë zhvillu demonstratat. Edhe mu m’patën caktu... unë isha bashkëpunëtor në Komitetit Krahinor... në Komunën e Lipjanit t’shkoj edhe të bisedoj me rini për kto zhvillimet e, a din, kadale pak e tjera. Edhe shkoj me ni fshat ku i kom dajtë aty, Akllap i thojnë, ni fshat, s’e di a e dini? Afër Janjevës, s’osht’ me randësi.

Edhe dajtë aty une i kom pasur edhe shkoj aty, mbahet mledhja me ju shpjegu zhvillimet aktuale, politike e tjera e tjera. Edhe m’thanë, “Po ju thrrasin” edhe rini ka pasë edhe m’kujtohet si mramje thotë, “me ju folë si sociolog, çka ta merr menja ty”. Ata ishin ma të lirë edhe unë isha ma i lirë me ta. Edhe m’bonin lloj lloj pyetje edhe une po ju tregoj për aspektin sociologjik të shoqërisë, zhvillimit të shoqërisë, kundërthanjet, problemet, shoqëria shkon përpara, mund të ngelet mbrapa, përspektivat e zhvillimit, globalizimi.

Unë në atë kohë flisja për këto qasje domethanë. Ata kufijtë anej knej, po edhe kufijtë në të ardhmën... ju interesonte për Kosova Republikë. “Po edhe kufijtë do të ndryshojnë në të ardhmën” anej knej. “Po a do të bohet Kosova Republikë?” Historia shkon përpara, zhvillimet shkojnë përpara. Ata m’kanë ndëgjua. Po ka qenë dikush që... që po thonë sot dikush është pagu për shpiunazh e

dikush nuk është pagu po ka punu pa pare. Dikush ka qëllu aty që e ka përcjellë bisedën edhe po m'bojnë pyetje për Kosova Republikë anej knej.

Une s'e kam përmend. "Shoqnia i ka ligjshmëritë e veta të zhvillimit" po ju thom e tjera, e tjera. Po çdo çështje e ka zhvillimin e zhvillimin e unë po ju thom atyne, po ja u boj me dije që kur t'i vjen koha, une s'ju kom thanë për republikë. E kryj une mledhjen e nesër po thrrasin prej Punëve të Brendshme të Lipjanit, "A po vjen me pi ni kafe?" Thashë, "Çka paska kërситë?" Edhe m'thonë ata sërbitë që kanë qenë funksionar... jemi njoftë se në Komitet Krahinor kom pasë kontakte, mledhje. "A ju ke thanë ti që Kosova Republikë do të bahet?" Thashë, "Unë kurrë nuk e kam përmend Kosova Republikë" "Po ti paske thanë" "Unë nuk kom thanë".

Edhe aty ka qenë, në atë bisedë edhe kryetari i komitetit i kemi thanë të partisë ai osht' ni... Hasan Lekiqi nga Gadimja, osht' gjallë ende edhe ai ma ka dhanë përkrahjen. Ka thanë, "E kanë keqkuptue Eminin. E di une çka ka folë Emini" anej knej edhe ai m'ka ndihmu. Përndryshe, une kom pasë të shkoj në burg edhe me hupë me punë e me krejt. Ni përvojë shumë e idhtë. Domethanë, asni sërbi nuk ka qenë aty të gjithë kanë qenë shqiptarë. Po dikush ka punu pa pare edhe gati se m'kanë marrë në qafë. Edhe pastaj kam qenë shumë i kujdesshëm.

Anita Susuri: Pas... ju thatë që nuk keni qenë prezent kur janë largu kroatët.

Emin Bikliqi: Jo.

Anita Susuri: A e keni vrejtë atë dallimin?

Emin Bikliqi: Po, po. Unë në atë javë që ka ndodhë ajo... mrenda javës thonë që kanë shkue. Aq janë friksue, i kanë marrë mjetet ato kryesoret çka i kanë pasë, ato të vlefshmet edhe shtëpitë i kanë lanë me dry, i keni pa. Sot e kësaj dite, do të rrënume do gjysmë të rrënume, shkret, zombi. Shumë e randë, shumë e vështirë. Edhe unë shkoj masanej, meniherë është vrejtë. Çarshia osht' shprazë, nuk ka pasë gjallni, nuk ka pasë aso jete çfare jemi mësu na me Janjevën.

Në Janjevë kanë shku kanë pi kafe funksionarët e Kosovës ose ndonjë mëngjes si thonë, ndonjë drekë atje. E sot ajo ka mbetë, që ka thanë Nastradini, "As fshat as qytet". Ka mbetë kërkund. Domethanë, nëse ka mbetë... jo nëse ka mbetë po nëse ka ra ndonjë vendbanim ma poshtë se sa që ka qenë, Janjeva është. Ajo s'ka mujtë as atë nivelin... fundosë gati. Është e dhimbshme. Duhet të jetë e dhimbshme për të tjerët, është e dhimbshme për ne. Në ni vend ku kom lindë e ku kom kalu ni pjesë bukur t'mirë t'jetës.

Anita Susuri: Janjeva njihet edhe si vend që ka pasë shumë kafene, shumë jetë të natës. A keni qenë edhe ju pjesë e qasaj?

Emin Bikliqi: Jo, jo shumë. Jo s'kom pasë kohë me ju thanë të drejtën unë nuk kam qenë prej atyre. Unë ju tregova, kom punu në atë institucion ku ka pasë kujdes për sjelljet e mia, për moralin tim, për të gjitha kto edhe në atë kohë kemi pasë përgjegjësi të mëdha. Kemi pasë përgjegjësi partiake,

përgjegjësi të llojllojshme. Domethanë, s'ke guxu ti bash me bo çka të dush e tjera, e tjera. Unë kam qenë njëri prej të disiplinuarve. Kam marrë pjesë në aktivitete që kanë të bëjnë me punën e institucionit që kam punue, kemi punu gjithë ditën. Kemi punu për të mirë, në qat' kohë kur kemi qenë, që po them Kosova Amerikë. Kemi mbajtur mledhje, kemi bo luftë për të drejtat e shqiptarëve për shkollim e për emancipim e për shumëçka. Për shumëçka se ka qenë programi i partisë i tillë që me i dhanë mundësi kombeve, sidomos mundësive për ni zhvillim ma të shpejtë e ma të mirëfilltë e ma të mirë e tjera.

Anita Susuri: Gjatë asaj kohe...

Emin Bikliqi: E unë kam qenë në funksion të asaj edhe vetën edhe ato nevojat e mia për ngritje profesionale kanë qenë në ato rrethana minimale. Se me gjithë qenien time jam përkushtue zhvillimit të shoqërisë. I kemi dhanë shoqërisë demokratike që e ka meritue, tjetër qëllimi ynë që ka qenë për pavarësi e tjera. Mirëpo, si shoqni qysh jemi jetue na, na kemi jetu në përgjithësi mirë. Në atë kohë kryesisht kanë qenë të punësuar, rrallë kush ka qenë i punësuar. Ka pasë mundësi kush ka dashtë ka shku në Gjermani për shembull, s'ka gjetë punë... ni kohë jepnin pare, bonin korrupsion kta të punësuarit në Gjermani e Francë për t'u punësuar ktu. Rrogat e mira kanë qenë. Me 1 mijë e 500 marka, 2 mijë marka, 1 mijë marka në atë kohë, në atë kohë marka ka pasë vleftë të madhe. Domethanë, krejt kjo ka qenë... çka kemi bo në funksion të zhvillimit të shoqërisë. Edhe unë kom sakrifiku, në vend që të magjistroj e të doktoroj... nuk kam mund t'i kushtoj kujdes ngritjes profesionale që m'pytët, ndoshta dy herë iu përgjigja.

Anita Susuri: Periudha e luftës në Kosovë si ka qenë për juve?

Emin Bikliqi: Tmerr, tmerr se unë... na e kemi pasë djalin në Mitrovicë edhe ku të shkojmë? Ju s'jeni prind, ju jeni të reja tash nuk e dini atë ndjenjën e prindit. Për shembull, në ato rrethana të bombardimeve, të luftës, të shkatërrimeve me e lanë fmijen në burg edhe unë me shku në Maqedoni ose në Shqipëri e tjera... unë i thoja zonjës time edhe dy djem që i kisha, "Shkoni ju une po rri se nashta i lshojnë" a din, andërr shihsha. Nashta e lshojnë e ku me shku djali, "e unë po rri", "Jo, ja po rrijmë të gjithë ja..." Edhe kem mbetë edhe tmerr ka qenë. Sa herë na kanë ardhë me na mytë e me na pre, anej knej. A kanë ditë ata për djalin nuk e di. Në katin e katërt banoj, në katin e parë kanë qenë 20 policë. Njëri e pati lshu banesën, qaty gjithë natën të pijavun, vishin te dera anej knej. A kanë ditë për djalin a s'kanë ditë nuk e di.

Vishin me maska. Unë e disha mentalitetin e tyre. Vishin me maska, "Hajdeni pijeni ni kafe. Qe po ju qes raki" mbajsha raki, tash rreziku... unë e qelsha rakijën që a din kishe me ju bo muhabet e mos me na ngucë. E ata kishin dëshirë me pi raki, po nom. Nihërë na patën marrë djalin e madh se ky i vogli e kom pasë krejt të vogël e i kanë çu i kanë malltretu mos kanë pasë armë. Lloj lloj momente që na gati... pa trauma s'kemi mbetë që kur u kryen krejt na pysnin, "Qysh jeni?" "Nuk e dimë a jemi tamon" mas gjithë atyne e tjera.

Masanej që i dërgun për Serbi edhe qe qishtu krejt në pritje. Zonja shkonte... vetëm gratë kanë pasë të drejtë me shku me i vizitu. Vinin prej Preshevës taksistat i çonin për Pozharevc mrena ditës, herët

vishin i merrshin edhe ka 200 marka për njeri kemi pagu vëllezërve tanë preshevar. Na në siklet tonin në telashe tona, po për neve vetëm a ka mundësi me e pa fminë. I kemi dhanë edhe ka 200 marka për ni transport që thojnë deri në Pozharevc edhe jemi kthy. Ai ka 800 marka në ditë i fitonte me ni turrë taksi që bonte. Ishalla s'kanë nevojë të tjetër si na që kemi pasë nevojë ose ata.

Anita Susuri: Ditën e çlirimit si e keni përjetu?

Emin Bikliqi: Aiii...

Anita Susuri: A ju kujtohet ajo ditë?

Emin Bikliqi: Qysh s'më kujtohet, qysh s'kujtohet ajo ka qenë mrekulli, mrekulli. Po, ajo ka qenë mrekulli po unë, si thonë, na me zemër të thynë që se kishum djalin po me shpresa, a din? Shpresat ishin ma të mëdha që do të lirohen mandej me abulacion ua falën. Ai shtatë vjet ka qenë i dënum. Me abulacion mandej i lshun, ja u bonën tri vjet burg. Edhe u kthy shnosh e mirë. Pritja në Merdare ato (qan)...

Anita Susuri: Si e keni pritë?

Emin Bikliqi: (qan) Motivi prindëror është... ju e keni mësu kta gjatë shkollimit, motivi ma i fuqishëm në botë. E keni pa në psikologji ato eksperimente që janë bo me minjë. Miu ka sakrifiku për të voglin e vet. Ka kalu në flakë e në zjerm e le ma te qeniet njerëzore. Ajo osht' edhe me, me ni vetëdije ma të lartë e ku ta di e tjera e tjera.

Anita Susuri: Sa fëmi i keni ju?

Emin Bikliqi: Tre djem.

Anita Susuri: A janë të shkollum apo me çka mirren?

Emin Bikliqi: Po, po. I madhi Albioni ai është inxhinier i IT teknologjisë, ky i dyti Artani që ka qenë në burg, ai është magjistër i gjuhës angleze edhe Yllori është i treti osht' profesor i gjuhës angleze.

Anita Susuri: Si ka vazhdu jeta juj mas periudhës t'luftës?

Emin Bikliqi: Qishtu me telashe, me telashe rreth punësimit e rreth... unë nuk kam mund të punësohem, nuk kam mund të punësohem. Ka shku puna krejt me lidhje edhe jom marrë me tregti edhe ma herët edhe ma vonë. Edhe dikur vendosi... e hapën ni shpallje, ni konkurs për përkthysë në gjykatën e lartë edhe konkuroj unë, shkoj aty. Edhe dy gjuhtë unë i njoh, i kam njohur mirë edhe i njoh mirë, pa konkurrencë kam qenë aty. Edhe më pranojnë. Unë për seri thashë hajt të konkuroj edhe aty kam punu edhe aty jam penzionu. Mirëpo, ky djali kur u kthy prej burgut, ky e kreu fakultetin...

Anita Susuri: Pas luftës?

Emin Bikliqi: Pas luftës e ka kry fakultetin edhe pjesëmarrës i luftës e tjera e tjera. Ka konkuru edhe kërkund s’e kanë pranë. Me fjalë të tjera, domethanë, s’ke pasë lidhje... ajo vazhdon atëherë edhe tash, s’ke pasë lidhje e kotë. Pjesëmarrës i luftës edhe jo. Ai mandej është punësue në Oxford. Oxford-in p’e dini për gjuhë të huja, ni institucion privat. Qe çka kanë ba tantë për bashkëluftëtartë a për kta për tezak e vlla është tjetër muhabet, për kta gjithçka.

Anita Susuri: E tash... m’falni që po ju ndërprejë.

Emin Bikliqi: Po.

Anita Susuri: Me çka merreni tash?

Emin Bikliqi: Unë?

Anita Susuri: Si e kaloni kohën?

Emin Bikliqi: Jo unë kohën e kaloj mirë. Tash merrem me përkthime. Unë nuk jam përkthysë, po merrem me përkthime. Besoj mirë përkthej. Edhe me disa kompani bashkëpunoj po nuk thrrasin shpesh. Najhere dikush që e din që jam përkthyes i licencuar që thojnë e kam vulën e tjera, më sjellë diçka i përkthej. Lexoj brenda mundësive. Në Gërmi dal me disa shokë pijmë nga një kafe, te Freskia zakonisht. Në Janjevë shkoj, merrem me aktivitete fizike si thonë kështu me pemë e me vreshtari...

Anita Susuri: Deshta me iu vetë edhe për Janjevën për diçka se kam ndëgju që ka pasë shumë pemë edhe perime Janjeva ma herët...

Emin Bikliqi: E vërtetë. Perime jo, pemë ka pasur shumë. Edhe diçka nuk ju... tash po më pytni edhe po më kujtohet. Kodrat tash që janë të Janjevës duken shkret, në atë kohë domethanë derisa kanë qenë kroatët ato kanë qenë si lulishte. Vreshtat kanë qenë krejt me mejë si thonë edhe të dallume edhe të punume me hardhi të rrushit edhe me lloj lloj peme. Sepse kta kanë shku nëpër gjithë Jugosllavinë edhe kanë sjellë lloj lloj peme, lloj lloj peme që tjetër as andërr s’i kanë pa përreth neve.

Për tjetër nuk e di. Për Komunë të Lipjanit s’kanë pasë lidhje ata kanë ardhë te na për rrush, për dardha, pjeshka, qershia, vishnje, kumbulla ku ta di. Do të thotë kto i kanë sjellë kroatët aty. Ato vneshta kanë qenë o mrekulli po edhe ma e mrekullueshme kur bahej vjelja e rrushit, po du me thanë për Janjevën. Jo për shqiptartë e për turqit, te kroatët ata kanë pasë ma së shumti vreshta sesa na. Se kanë qenë 80 përqind kroat na 20 përqind kemi qenë. Edhe ato vajza të bukura dilnin me vjelë rrush edhe këndonin këngë dalmatine.

Mundeni me marrë me mend. Edhe ato kodrat e Janjevës, e këndon me ni kodër zani shkon gati në gjithë Janjevën. E mrekullueshme, për mu, e mrekullueshme. Ajo m’kujtohet. Edhe nganjëherë ulem edhe bisedoj me shokë kroat thom, “A e dini atë kohë?” Edhe ktheheshin për shembull me shporta,

me rrush ose me pemë vajzat e bukura nëpër shtëpi, nëpër Çarshi e tjera e tjera. Mrekulli ka qenë, mrekulli. Edhe unë i kom pasë edhe i kom dajtë e tezet në Banullë p'e dini Banullën? Fshat.

Anita Susuri: Po.

Emin Bikliqi: Ata vetëm ni dud e kanë pasur në oborr. Edhe në kohë të qershiave deri në rrush vinin te na. Edhe na m'kujtohet, "Pse teze s'po mbjellni sikur te na pjeshka e molla?" "Nuk bohen te na". Me mend çfarë informate kanë pasë, domethanë s'kanë pasë informacion. Jeta është informacion. Jeta është informacion. Ata nuk kanë pasë informacion se bohen edhe pjeshkat edhe rrushi midis Banullës e Lipjanit e ku të dush, a është qashtu?

Edhe sot me shku në Banullë kanë bo mrekulli, lloj lloj peme. Mirëpo, po kthehem, neve kroatët na kanë çelë sytë e masanej tanët kanë fillu me i çelë sytë edhe në Lipjan edhe në Banullë edhe gjetiu, e tjera. Ose është edhe ni shprehje interesante, po edhe për ju edhe për opinionin, informacioni është çelësi i suksesit. Edhe sot, ki informacionin ke sukses, s'ke informacionin s'ke kurgjo. Edhe në atë kohë s'kanë pasë informacion që pjeshka edhe rrushi bon edhe në rrafsh e jo vetëm në kodra.

Anita Susuri: A ka edhe diçka për fund nëse keni harru me shtu?

Emin Bikliqi: Po, ka. Por tash varet, varet çka? Sigurisht ka edhe ndonjë moment, por kto janë ato që dominojnë, se njeri s'mund t'i thotë të gjitha. Kto i thotë vetëm me laps, kur ulesh edhe ngadalë dalë nji pas nji. E kështu me ni intervistë është pak ma problem me i përfshi të gjitha.

Anita Susuri: Mirë, faleminderit shumë.

Emin Bikliqi: Me nderë qofshi edhe juve sukses.